VENDIM
Nr. 18(K)2023 i Regjistrit Themeltar,
datë 8.11.2023

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Genti Ibrahimi,	anëtar,

në datën 8.11.2023, mori në shqyrtim paraprak çështjen nr. 18 (K) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë

OBJEKTI: Shfuqizimi i pikës 2, të nenit 1 dhe pikave 1, 2 dhe 5, të nenit 2, të ligjit nr. 77/2022, datë 17.11.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015, 'Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave"', si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i pikave 2, 3/1 dhe 3/2, shkronja "c", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 313, datë 24.5.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 223, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave', të ndryshuar", si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i pikës 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 313, datë 24.5.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 223, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave', të ndryshuar", në pjesën që shton pikën 16/7, në vendimin nr. 223, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pezullimi i zbatimit të këtyre akteve deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese *(Mbledhja e Gjyqtarëve),* pasi mori në shqyrtim paraprak kërkesën e paraqitur nga kërkuesi për pezullimin e zbatimit të akteve të kundërshtuara,

VËREN:

1. Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, në datën 17.11.2022, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 77/2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015, 'Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të

kompensimit të pronave"' *(ligji nr. 77/2022)*, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 168, datë 15.12.2022 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në këtë fletore.

2. Po kështu, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 8, pika 5, 16, pika 6/2, dhe 37' të ligjit nr. 133/2015' "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" *(ligji nr. 133/2015)*, me propozim të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr. 313, datë 24.5.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 223, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave', të ndryshuar" *(VKM-ja nr. 313/2023)*, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 79, datë 25.5.2023 dhe ka hyrë në fuqi pas botimit të tij në këtë fletore.

3. Në datën 18.9.2023, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë *(kërkuesi)* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me kërkesë për shfuqizimin e neneve 1, pika 2, dhe 2, pikat 1, 2 dhe 5, të ligjit nr. 77/2022, si dhe të pikave 2, 3/1, 3/2, shkronja "c", dhe pikës 8, në pjesën që shton pikën 16/7 në VKM-në nr. 223/2016, të VKM-së nr. 313/2023, duke pretenduar se cenojnë parimin e sigurisë juridike, të drejtën e pronës, të drejtën për shpërblim të drejtë, parimin e proporcionalitetit, parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, si dhe se pika 8, e VKM-së nr. 313/2023, cenon edhe parimin e hierarkisë së akteve normative. Po kështu, kërkuesi ka kërkuar nga Gjykata edhe pezullimin e zbatimit të këtyre akteve deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës, duke pretenduar se, si trashëgimtar i pronave të tij, ka një sërë çështjesh për shqyrtim në Agjencinë e Trajtimit të Pronave *(ATP)* dhe në gjykatat shqiptare, të cilat u nënshtrohen rregullimeve që kërkon të shpallen si antikushtetuese.

4. Neni 45, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)* parashikon se Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës të hyjë në fuqi. Po kështu, edhe neni 11, pika 3, shkronja "f", i Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës parashikon kompetencën e Mbledhjes së Gjyqtarëve për të vendosur pezullimin e ligjit ose të aktit, ndërsa sipas nenit 27, pika 2, të kësaj Rregulloreje, në rast se shqyrtimi paraprak i kërkesës bëhet nga Mbledhja e Gjyqtarëve, kjo e fundit, kur vendos kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare shprehet edhe për kërkesën për pezullim, përveçse kur vlerëson se ajo duhet të shqyrtohet në një datë të mëvonshme ose pasi të dëgjohen palët në seancë plenare.

5. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se shkaqet e parashtruara nga kërkuesi lidhur me kërkesën për pezullimin e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 77/2022, janë të përligjura në kuptim të nenit 45, të ligjit nr. 8577/2000, duke pasur parasysh rëndësinë e të drejtave dhe lirive themelore në garantimin e shtetit të së drejtës, si dhe pasojat eventuale që mund të vijnë si rezultat i cenimit të barazisë së shtetasve.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nenet 11, pika 3, shkronja "f", dhe 27 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, me shumicë votash,[1]

[1] Gjyqtarët Elsa Toska, Sonila Bejtja dhe Sandër Beci u shprehën kundër pezullimit të zbatimit të ligjit nr. 77/2022,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 77/2022, datë 17.11.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015, 'Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave"'.

2. Njoftimin e kërkuesit dhe të subjekteve të interesuara për marrjen e masës së pezullimit të ligjit.

3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese dhe dërgimin e tij për botim në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 8.11.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska

Anëtarë kundër: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska

---

pasi kërkuesi nuk ka paraqitur argumente të mjaftueshme në lidhje me pasojat e rënda që sjell zbatimi i tij, kriter i pranuar edhe nga jurisprudenca e mëparshme e Gjykatës, për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 133/2015 *(shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*. Nga ana tjetër, ligji nr. 77/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare në datën 17.11.2022 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit, konkretisht në datën 3.12.2022, ndërsa kërkesa drejtuar Gjykatës mban datën 18.9.2023, ndaj edhe në këtë kontekst rrethanash kushtetuese, ai nuk ka arritur të argumentojë menjëhershmërinë, pra pasojat aktuale që do të duhej të parandaloheshin menjëherë përmes pezullimit të ligjit objekt kundërshtimi.